



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë si dhe nenit 20 par. 20.1, 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kërkon nga Kuvendi i Komunës që në mbledhjen e datës _____ të miratojë këtë:

PROPOZIM

V E N D I M
PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Me këtë Vendim themelohet Komiteti për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Neni 2

Komiteti për Komunitete ka mandat 4 vjeçar

Neni 3

Kryesuesi i Komitetit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

Neni 4

Për anëtarë të Komitetit për Komunitete emërohen si vijon:

1. _____ anëtar i Kuvendit -LDK
2. _____ anëtare e Kuvendit -LDK
3. _____ anëtare e Kuvendit -LDK
4. _____ anëtare e Kuvendit -PDK
5. _____ ,anëtare e Kuvendit -LVV
6. _____ ,komuniteti ashkali
7. _____ ,komuniteti rom
8. _____ ,komuniteti serb
9. _____ ,komuniteti turk
10. _____ ,komuniteti malazez
11. _____ ,komuniteti kroat

Neni 5

Komiteti për komunitete në pajtim me dispozitat e nenit 53 par.53.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ka detyrë dhe përgjegjësi si vijon:

Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht.

Komiteti gjithashtu i rekomandon kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmiren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit faqen elektronike të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e e neneve 12, 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Udhëzimit administrativ nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve për përhershme në Komunë si dhe nenit 20 par. 20.1 , 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15.Nr.110-78095 të dates 24.12.2021

Nga të cekurat më lartë propozojmë miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

15Nr. 020/08-67572
Lipjan, më 10.12.2025

KRYESUESI I KUVENDIT

Daut Azemi

